



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS**

U D H Ë Z I M

Nr. 824 Datë 10.02.2017

PËR

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË PERFORMANCËS, KONTRATËS
SË PERFORMANCËS (MODEL TIP) PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE
NË SEKTORIN E UJËSJELLËS KANALIZIMEVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të germës ç), të nenit 28, të ligjit nr.9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të VKM nr.63 datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, dhe Lidhjes nr. 1 të saj “Statuti tip i shoqërive aksionere shtetërore të ujësjellës kanalizimeve”,

U D H Ë Z O J:

1. Nënshkrimin e Marrëveshjes së performancës midis Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve (AKUK) dhe Bashkisë, sipas Lidhjes 1 - Model “Marrëveshje performance”, së bashku me Anekset 1, 2 dhe 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Këto marrëveshje të monitorohen nga MTI.
2. Nënshkrimin e Kontratës së performancës midis Bashkisë/Asamblesë së Përgjithshme dhe Këshillit të Administrimit/Administratorit të Përgjithshëm, sipas Lidhjes 2 - Model “Kontratë performance”, së bashku me Anekset 1, 2 dhe 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Secili nga dokumentat e parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij udhëzimi, do të negociohen nga palët nënshkruese dhe do të përshtaten sipas kushteve specifike të secilës Shoqëri Ujësjetllës Kanalizime, por duke ju përmbajtur modeleve bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe anekseve përkatëse.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve, të gjitha bashkitë, të gjithë Sh.a Ujësjetllës Kanalizime.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS

SOKOL DERVISHAJ